



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

P.A.nr.17/2026

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare, Faton Ademi dhe Lumni Sallauka, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leotrim Avdyli, në çështjen juridike në konfliktit administrativ sipas padisë së paditëses: Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me seli në Prishtinë rruga “Luan Haradinaj” p.nr. Ndërtesa e Ish Rilindjes, kundër të paditurës: Oda e Avokatëve të Kosovës me seli në Prishtinë, rruga “Bekim Fehmiu” pnr, Ndërtesa “Arting” Kati IV, me bazë juridike: shpalljen e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e lartësisë së shpenzimeve për regjistrim në Odën e Avokatëve të Kosovës, pas shqyrtimit paraprak të padisë, më datë 22.06.2026, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia e paditësit: Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë parashtruar kundër të paditurës: Oda e Avokatëve të Kosovës me seli në Prishtinë, rruga “Bekim Fehmiu” p.nr, Ndërtesa “Arting” Kati IV, si e palejueshme.

A r s y e t i m

Paditësi: Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë, përmes të autorizuarës së saj Avokatura Shtetërore me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me datë 12.06.2026 ka parashtruar padi ndaj të paditurës Oda e Avokatëve të Kosovës me seli në Prishtinë.

Gjatë shqyrtimit paraprak, në përputhje me nenin 33 paragrafët 3.3 dhe 3.4 të Ligjit për Konfliktet Administrative (Ligji Nr.08/L-182), gjykata ka vërejtur se padia e paditësit nuk është e qartë dhe e kuptueshme, në drejtim të aktit të cilin e konteston, e që ky fakt e pengon gjykatën në shqyrtimin e mëtejshëm të themelësisë së parashtrësës - padisë.

Gjykata, me aktvendimin e datës 12.06.2026, ka obliguar paditësen që të bëjë korrigjimin - plotësimin e padisë së datës 12.06.2026.

Paditësja me parashtrësën e datës 18.06.2026, ka bërë plotësimin e padisë dhe precizimin e saj. Në parashtrësë paditësi ndër të tjera kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës, që të shfuqizoj si të kundërligjshëm lartësinë e shpenzimeve të regjistrimit të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat, gjykata vlerësoj se në rastin konkret padia e dorëzuar nga paditësi në këtë gjykatë, e cila është regjistruar si padi: PA.nr.17/2026, nuk hynë në kompetencë për shqyrtimin lëndor të kësaj gjykate. Gjatë shqyrtimit paraprak të padis, u vërtetua se aktin të cilin e konteston paditësja në këtë çështje administrative nuk është akt nënligjor posaçërisht një akt i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga Kuvendi ashtu siç e përcaktojnë edhe dispozitat e LKA-së. Tutje, paditësja në padi i është referuar shfuqizimit të lartësisë së shpenzimeve për regjistrim, të cilat shpenzime janë të përcaktuara tek “Kërkesa për regjistrim në regjistrin e avokatëve”, e që kjo kërkesë nuk i plotëson kriteret e një akti nënligjor normativ.

Sipas nenit 10 paragrafi 4 të LKA-së, Gjykata Supreme ka kompetencë të shqyrtojë vetëm: revizionet e paraqitura kundër aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së dytë, të cilat i paraqiten gjykatës së shkallës së parë dhe paditë për shfuqizimin e akteve nënligjore normative, që paraqiten drejtpërdrejt në këtë gjykatë. Andaj, nga përmbajtja e padisë nuk rezulton se rasti ka të bëjë me ndonjë akt nënligjor normativ dhe as me revizion.

Në mbështetje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 3/10 Janar 2024, Prishtinë, përcaktohet se:

Neni 3 [Përkufizimet] *“1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1.1. Akt nënligjor normativ - një akt, i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga Kuvendi, që përcakton rregulla të detyrueshme sjellje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme”.*

Neni 10 [Organizimi dhe Kompetenca] “1. Organizimi i sistemit të gjykatës apo gjykatave kompetente për gjykimin e konfliktit administrativ, dhe juridiksioni apo kompetenca përkatëse rregullohet me ligj të veçantë. 2. Përveç kur parashihet shprehimisht ndryshe me ligj, të gjitha konfliktet administrative, gjykohen fillimisht në shkallë të parë. 4. Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe si shkallë e parë dhe e vetme, padinë për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normativ”.

Neni 13 [Llojet e padive] “1. Në konfliktin administrativ, paditësi mund të kërkojë: 1.1. anulimin e një akti administrativ (në tekstin e mëtejme “padia e anulimit”); 1.6. shfuqizimin e një akti nënligjor normativ (në tekstin e mëtejme “padia ndaj aktit nënligjor normativ”)”.

Neni 25 [Padia për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ] “1. Me padinë për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, paditësi kërkon deklarin e paligjshmërisë të një dispozite të një akti nënligjor normativ apo të tërë aktit nënligjor normativ në tërësinë e tij dhe përkatësisht shfuqizimin e tyre”.

Neni 35 [Shqyrtimi paraprak i padisë] “Gjykata fillimisht shqyrton kompetencën e saj mbi çështjen, nëse padia është apo jo e plotë dhe e kuptueshme, dhe nëse padia është apo jo e lejueshme, gjegjësisht plotësohen kushtet procedurale për paraqitjen e padisë”.

Neni 38 [Padia e palejueshme] “1. Gjykata hedh poshtë padinë, si të palejueshme për gjykim në themel, nëse në gjykimin e saj, rezulton, se: 1.5. nuk plotësohet një nga kushtet tjera të përgjithshme apo të veçanta procedurale, e parashikuar me ligj, për paraqitjen e padisë. 4. Hedhja poshtë e padisë sipas këtij neni bëhet me aktvendim”.

Neni 59 [Procedimi i padisë me objekt shfuqizimin e aktit nënligjor normativ] “6. Nëse kolegjii shqyrtues, në seancë të trupit gjykues, unanimisht vjen në përfundim se kërkesa nuk i plotëson kushtet formale për procedim të mëtutjeshëm dhe për këtë shkak nuk është e lejueshme, shpall vendimin me të cilin hedhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë”.

Pasi gjykata vlerësoj se akti i kontestuar nuk përmban elementet e një akti nënligjor normativ, dhe si rrjedhojë nuk janë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për shqyrtim të mëtejshëm të aktit të kontestuar nga paditësi pranë kësaj gjykate, siç përcaktohet në nenin 38, paragraf 1 nën-paragraf 1.5, si dhe duke pasur parasysh mos përmbushjen e kushteve të

përgjithshme dhe veçanta procedurale, përfshirë kompetencën ligjore të kësaj gjykate, dhe nuk ka asnjë aktgjykim apo lëndë objekt shqyrtimi sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, padia hedhet poshtë si e palejuar, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë lejueshmërinë e padive në konflikt administrativ.

Gjykata Supreme, në referim të nenit 10 paragraf 4 të LKA-së, vlerësoj se kjo gjykatë, gjykon sipas revizionit dhe si shkallë e parë dhe e vetme, ndaj kërkesëpadive për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normativ, të gjitha paditë e tjera gjykohen në gjykatën e shkallës së parë si gjykatë kompetente.

Për shkaqet e përcaktuara si më lartë dhe në mbështetje të nenit 38 lidhur me nenin 59, paragraf 6, të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

P.A.nr.17/2026, të datës 22.06.2026

B. Profesionale
Leotrim Avdyli

Kryetare e kolegjit
Delushe Halimi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVA JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARITATI - SEKRETATIJTAT - SECRETARIAT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD

Shenja e kërkesës: P.A.nr.17/2026
Znak zahteva Ev. D.H

FLETËGËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL
OTPREMNICA ZA LICNU DOSTAVU

Marrësi/Prima:

Oda e Avokatëve të Kosovës me seli në Prishtinë, rruga
“Bekim Fehmiu” pnr, Ndërtesa “Arting” Kati IV

1. Pasi marrësi nuk u gjet në vendin e ku duhet të dorëzohet
shkresa, pas lënies së lajmërimit me shkrim, dorëzimi u bë duke
iu dhënë shkresat anëtarëve madhor të familjes së marrësit –
kujdestarit të ndërtesës, fqit, personit që punon në të njëjtin
vend të punës me marrësin.

1. Posto primilac nije zatecen na mestu gde se dostvaljanje
ime izvrsi-ti, dostava je data odraslom clanu domacinstva
primaoca – nastonjiku.

2. Pasi marrësi ose pjesëtari i familjes së tij e ka refuzuara
marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së
marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku
gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno clan njenog domcinstva odbio
orijem, pismo je dostavljeno u stanu – radno mestu primaoca
(pribiena na vratima stana osnosno prostorije gde je primilac
zaposlje)

Më datë: ___/___/___ në ora ___:___
Dana U cas.

Shkaku i refuzimit _____
Rezlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit – potpis dostavljača

Titulli i shkresës që dorëzohet/Naslov
pisma koja se dostavlja:

1). Aktvendim i datës 22.06.2026

Numri i shtojcave: 2
Broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më
(me fjalë) / Povrdjemo prijem gorenavegong
pisma (i slovima)

Nënshkrimi i marrësit – potpis primaoca

Të panevojshme bjeri vizë – nepotrebne precrtali

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruaj dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet / Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljac, nepomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

ita Supreme
i Digitesis

ne